



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.349/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES, Dhomat e shkalles se pare, Departamenti per Çeshtje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, ne çeshtjen juridike te paditesit Kolegji BPrAL “UBT”, sh.p.k me seli ne Prishtinë, me NUI 810514853, i përfaqësuar nga A.T. sekretar, kundër të paditurës Ministria e Financave me seli në Prishtinë (MF), sipas padisë se paditësi për Anulim Vendimi nr. 287/2020 të datës 22.09.2020 të MF dhe rimbursim te mjeteve financiare nga Pako Fiskale Emergjente, konform nenit 13 paragrafi 7 te Ligjit nr. 08/1-015 për Gjykatën Komerciale (LGJK), jashtë seancës, me date 21.03.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale te Kosovës, Dhomat Shkalles se Pare - Departamentit per Çeshtje Administrative shpallet jo kompetente për ta gjykuar këtë çështje.
- II. Pas plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi lënda i dorëzohet Gjykata Komerciale te Kosovës, Dhomat Shkalles se Pare - Departamentit për Çështje Fiskale, si departament kompetente për ta gjykuar këtë çështje juridiko – civile.

A r s y e t i m

Me datë 22.10.2020, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Administrative, paditësi Kolegji BPrAL “UBT”, sh.p.k me seli ne Prishtinë, me NUI 810514853, i përfaqësuar nga A.T. sekretar, kundër të paditurës Ministria e Financave me seli në Prishtinë (MF), sipas padisë se paditësi për Anulim Vendimi nr. 287/2020 të datës 22.09.2020 të MF dhe rimbursim te mjeteve financiare nga Pako Fiskale Emergjente. Lënda është evidentuar me nr. A.nr. 1753/2020.

Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur nga Gjykata Themelore në Prishtinë– Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatën Komerciale të Kosovës, Dhomat Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative dhe evidentohet me shifren KA 349/22 .

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamentit për Çështje Administrative, shqyrtoi përmbajtjen e padisë konstatoi se shqyrtimi i padisë është në Kompetence të Departamentit Fiskal.

Me Ligjin nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale (LGJK) përcaktohet juridiksionin ekskluziv të secilit Departament në Dhomat e Shkallës së Parë. Neni 13 paragrafi 4 lidhur në paragrafin 1 përcakton të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.11 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti Fiskal; ku në paragrafin 1.11. përcaktohen kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të Administratës Tatimore, Autoriteteve Doganore, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve të tjera shtetërore;

Duke pas parasysh se vendimi i kundërshtuar nga nr. 287/2020 të datës 22.09.2020 është nxjerrë nga Ministria e Financave, vleresimi i ligjshmerisë së aktit administrativ, bie në kompetence të Departamentit Fiskal, bazuar në nenin 13, par. 1, nën par. 1.11 lidhur me par.4 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, nenin 17 të Ligjit për 06/L-054 për Gjykatat dhe nenin 19 dhe 392 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore lidhur me nenin 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti për çështje Administrative

KA.nr.349/22, datë 21.03.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KESHILLE JURIDIKE: Kunder ketij aktvendimi eshte e lejuar e drejta e ankeses, në afat prej 15 diteve, nga dita e pranimi te aktvendimit, ne Dhomat e Shkalles se Dyte te Gjykatën Komerciale ne Prishtine, permes Dhomave te Shkalles se pare te kesaj Gjykate